



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
- 4. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Valbona Bala, Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL), Sarmela Titka, (INL, Ambasada Amerikane)**
- 6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Vijon mbledhja “online”, pas shqyrtimit të çështjes së parë e cila u trajtua vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit.

Naureda Llagami: Fillojmë me çështjet e tjera.

Fillojmë me çështjen e parë që është një projekt-akt shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, i përgatitur ky nga Komisioni i Planifikimit. Në fakt mund të raportohet nga zoti Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit Kryetare!

Në vijim, nëse më lejoni të vazhdoj me relacionin e përgatitur për projekt-aktin e sapo përmendur nga ana juaj.

Të vazhdoj?

Naureda Llagami: Po, Ilir!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Relacion mbi projektvendimin “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja ‘ë’, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 84, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 14, 15 dhe 22 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është organi përgjegjës për përcaktimin e kompetencave territoriale dhe të madhësisë së gjykatave.

Bazuar në dispozitën e mësipërme, pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar me vendimet:

Nr. 129, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”;

Me vendimin nr. 130, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”;

Me vendimin nr. 132, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë”;

Me vendimin nr. 133, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”;

Me vendimin nr. 134, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”;

Me vendimin nr. 135, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”;

Me vendimin nr. 136, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”;

Me vendimin nr. 137, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Me vendimin nr. 138, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”;

Me vendimin nr. 139, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”;

Me vendimin nr. 140, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”;

Me vendimin nr. 141, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.

Këto vendime përcaktojnë parimet mbi të cilat riorganizohen 22 gjykatat e rretheve gjyqësore dhe fillimin më datë 01.05.2023 të funksionimit të 13 gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, me seli dhe kompetenca tokësore si më poshtë:

a) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me seli në qytetin e Beratit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan;

b) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me seli në qytetin e Peshkopisë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos;

c) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me seli në qytetin e Durrësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rrogozhinë;

ç) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me seli në qytetin e Elbasanit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Përrenjas;

dh) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me seli në qytetin e Fierit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër;

e) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me seli në qytetin e Gjirokastrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull;

ë) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me seli në qytetin e Lezhës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;

f) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me seli në qytetin e Korçës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec;

g) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me seli në qytetin e Kukësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë;

h) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me seli në qytetin e Sarandë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë;

i) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me seli në qytetin e Shkodrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz;

j) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamzë, Vorë dhe Krujë.

k) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me seli në qytetin e Vlorës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Vlorë, Selenicë dhe Himarë.

Në këto vendime Këshilli ka parashikuar se numri i gjyqtarëve të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Sarandë, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë do të miratohet me akt të veçantë.

Detyrimi i Këshillit për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë buron nga neni 22 i Ligjit 98/2016 i ndryshuar, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr

vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e efijencës së gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës. 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e efijencës së gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës. 3. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës. 4. Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Shqipëri. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efijencës së masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.”

Procesi i rivlerësimit të shpërndarjes së numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë është i ndryshëm nga ai i propozimit për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve. Ky i fundit kërkon miratimin nga ana e Kuvendit bashkë me propozimin për buxhetin në sistemin gjyqësor. Ndërsa procesi i rishpërndarjes kërkon angazhimin e Këshillit për të rishikuar numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë, duke u bazuar tek totali i numrit të përcaktuar me Dekret të Presidentit (legjislacioni në fuqi, neni 90 i Ligjit 98/2016) aktualisht prej 408 gjyqtarësh.

I qartë për detyrimin ligjor si më sipër, Këshilli ka vlerësuar se rishikimi i numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, ishte proces që lidhej pazgjidhshmërisht me procesin e riorganizimit të kompetencave tokësore e rishikimit të madhësisë së gjykatave ndryshe të njohur si Harta e Re Gjyqësore (HRGJ), sepse të dy proceset kërkonin analizë disa vjeçare të ngarkesës së gjykatave si dhe evidentimin e një normë mesatare ngarkese vjetore të çështjeve të reja për çdo gjyqtar të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Kjo e fundit u llogarit në kuadër të HRGJ, gjatë procesit të analizës së të dhënave statistikore për 5 vite (2018–2022). Në pamundësi për të ndryshuar numrin total të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, proces i cili tejkalon analizën e vlerësimit e bërë në kuadër të HRGJ, sepse përfshin edhe vlerësimin për Gjykatën e Lartë e Gjykatën

Administrative të Apelit, Këshilli tashmë e ka një raport vlerësues të ngarkesës mbi të cilin mund të gjykojë për ndryshimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Nga ana tjetër procesi i vlerësimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, duhet të synojë realizimin në mënyrë të ekuilibruar të objektivave si: garantimin e aksesit në drejtësi, uljen e kostove me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike si dhe rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara, qëllime të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 14 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky proces duhet të mbajë gjithmonë në vëmendje parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 15 të ligjit të sipërcituar, si numrin minimal të gjyqtarëve për gjykatën e shkallës së parë (pika 3 e nenit), si dhe një numër mesatar të çështjeve në vit, jo më të vogël se mesatarja për gjyqtar e llogaritur me bazë vjetore, sipas analizës së bërë 3 vitet e fundit.

Numri i gjyqtarëve lidhet pazgjidhshmërisht me krijimin e gjykatave të specializuara dhe rritjen e efikasitetit.

Analiza e të dhënave statistikore është bërë hollësisht në Raportin e Vlerësimit mbi Hartën e Re Gjyqësore, ku është konkluduar se për të ruajtur mesataren kombëtare të ngarkesës me çështje gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm duhet të kenë këtë numër gjyqtarësh. Përkatësisht, sipas këtij projekcioni është përcaktuar që:

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, 9 (nëntë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, 23 (njëzet e tre) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, 20 (njëzet) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, 21 (njëzet e një) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, 8 (tetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 72 (shtatëdhjetë e dy) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Ky numër është i barabartë me numrin e pozicioneve të gjyqtarëve të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të alokuar aktualisht në sistemin gjyqësor, pra prej 235 gjyqtarësh.

Në Raportin vlerësues të Hartës së Re Gjyqësore është konkluduar pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i ligjit nr. 98/2016 i ndryshuar, se përcaktimi i numrit të gjyqtarëve sipas projekt-aktit të KLGJ, është aktualisht mekanizmi kryesor i ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Programi kompjuterik i zhvilluar për të mbështetur analizën e hartës së re gjyqësore mundësoi vlerësimin e ngarkesës dhe të mesatares për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Ngarkesa e gjykatës përcaktohet, jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra, nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

Teknika e përdorur për të kryer analizën përfshin programimin matematikor, ose më konkretisht, një variant të analizës së mbështjellëses së të dhënave (Data

Envelopment Analysis – DEA) me kufizime në ponderim. Me zbatimin e kësaj teknike, janë përlogaritur vlerat e ponderuara të çështjeve për secilin nga llojet e mësipërme të çështjeve. Ponderimet e çështjes përlogariten si vlera mesatare të ponderimeve optimale të identifikuar nga algoritmi përkatës.

Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës rezultoi 429 çështje për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, përgjatë periudhës 2018–2022.

Për të përcaktuar ngarkesën e punës treguesit janë vlerësuar duke kërkuar vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës, shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, si dhe numrit minimal të gjyqtarëve në çdo gjykatë.

Ngarkesa e gjykatës është përcaktuar jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra nëse çështjet e ndërlukuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

Vlerësimi i ngarkesës është përlogaritur duke u bazuar në specifikimet e përgjithshme siç pasqyrohen edhe në një tabelë, çështjet komplekse me palë kundërshtare dhe çështje të lehta pa palë kundërshtare; gjithashtu për çështjet penale si çështje komplekse janë parashikuar çështjet e themelit, ndërsa si çështje më të lehta janë hetimi paraprak, seancë paraprake, kërkesë penale; për çështjet administrative, si komplekse janë të përgjithshme administrative, më të lehta kërkesa të tjera.

Ngarkesa mesatare kombëtare për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, me çështje e përdorura për qëllimet e vlerësimit të hartës si dhe përcaktimit të numrit të gjyqtarëve është: çështje mesatare për çdo gjyqtar është 429, nga të cilat 38% i përkasin çështjeve komplekse dhe rreth 62% çështjeve të lehta.

Për sa i përket vlerësimit për çdo gjykatë:

Nëse në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat do të caktohen 9 gjyqtarë, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor do të jetë 10, propozimi është për 9, duke marrë për referencë të gjitha kriteret e parashikuara sa më sipër.

Në lidhje me Gjykatën Dibër, sipas bashkimit matematikor dhe dekretit del 8. Sipas propozimeve të bëra nga Grupi i Hartës Gjyqësore, është 7 (shtatë).

Sa i përket Gjykatës së Durrësit, sipas dekretit apo bashkimit matematikor është 21. Sipas propozimit të hartës, të jetë 23.

Në lidhje me Gjykatën e Elbasanit, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor është 14, ndërsa në lidhje me hartën e re gjyqësore është 20.

Sa i përket Gjykatës së Fierit, sipas dekretit është 19 (në bashkim matematikor me Gjykatën e Lushnjës), ndërsa sipas propozimit të hartës, të jetë numri 21.

Në lidhje me Gjirokastrën, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor me Gjykatën e Përmetit, janë 10, ndërsa sipas Grupit të Hartës është propozuar të jetë 8.

Në lidhje me Gjykatën e Korçës, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor me Gjykatën e Pogradecit janë 18, ndërsa sipas propozimit të Hartës së Re Gjyqësore është 16.

Në lidhje me Gjykatën e Kukësit, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor me Gjykatën e Tropojës është numri 8, ndërsa propozimi sipas hartës është numri 7.

Në lidhje me Gjykatën e Lezhës, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor me Gjykatën e Kurbinit është 9, ndërsa sipas propozimit të hartës të jetë 12.

Në lidhje me Gjykatën e Sarandës, sipas dekretit e cila nuk bashkohet me gjykatë tjetër është 6, ndërsa sipas propozimit të hartës është 7.

Në lidhje me Gjykatën e Shkodrës, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor me Gjykatën e Pukës është numri 18, ndërsa propozimi i hartës është po 18.

Në lidhje me Gjykatën e Tiranës, sipas dekretit dhe bashkimit matematikor me Gjykatën e Krutës është numri 80, ndërsa propozimi i Grupit të Hartës është 72.

Në lidhje me Gjykatën e Vlorës, e cila nuk bashkohet me gjykatë tjetër, sipas dekretit është numri 14 i gjyqtarëve, ndërsa sipas propozimit të Grupit të Hartës të jetë numri 15.

Ky ishte relacioni përkatës për çështjen.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, ndonjë diskutim nga kolegët?

Brikena Ukperaj: Zonja Kryetare, mundem?

Naureda Llagami: Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Atëherë, nisur nga ngarkesa shumë e madhe e çështjeve për dy vitet e fundit të veprimtarisë gjyqësore, konkretisht për vitin 2021 dhe 2022, unë kam një propozim të ndryshëm për sa i përket numrit të gjyqtarëve, kryesisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që do jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por rritja e këtij numri sigurisht që do të afektojë edhe në uljen e numrit të disa gjykatave të tjera. Konkretisht, nga ana e Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor dhe Standardeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor na është përgatitur një tabelë me numrin e çështjeve të reja të regjistruara për katër vitet e fundit (sipas detyrimit ligjor). Kemi 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Kjo tabelë reflekton një rritje të konsiderueshme të numrit të çështjeve të reja kryesisht për Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, por që në bashkim me Krujën do jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila në bashkim me Krujën ka në total, për katër vitet, çështje të reja rreth 149.740, me një mesatare vjetore prej 37.435. Duke pasur parasysh këto të dhëna të reja statistikore të cilat nuk janë marrë parasysh nga eksperti, për arsye sepse analiza është bërë bazuar në të dhënat statistikore deri në vitin 2020, por duke zbatuar të njëjtin indikator të zbatuar edhe në kuadër të hartës gjyqësore për numrin mesatar të çështjeve të reja për gjyqtar, përcaktuar nga eksperti në vlerën 429 çështje, unë do të propozoja që për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të mos kishim ulje drastike të numrit të gjyqtarëve (për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) në 72, por të paktën të mbeteshim në kufijtë e bashkimit matematikor të strukturave ekzistuese të dy gjykatave Tiranë dhe Krujë. Pra numri i gjyqtarëve të shkojë në 80.

Pavarësisht se, edhe në qoftë se ne zbatojmë këto të dhëna statistikore, në fakt numri shkon rreth 87, por gjithsesi ne nuk mund të dalim dot tej numrit 235 që parashikon dekreti për numrin e gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Duke mbajtur këtë numër për Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (pra duke shkuar në 80 gjyqtarë), nga ana tjetër propozoj që për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, numri i gjyqtarëve të mos jetë 9 por të jetë 8 (tetë). Ky numër gjyqtarësh i propozuar, referuar 3474 çështje mesatare në vit, të reja që shkojnë në këtë gjykatë, e pjesëtuar me 429 çështje për gjyqtar, justifikon vijimin e punës me 8 gjyqtarë.

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër nuk kam propozim tjetër sepse është 7 (shtatë) gjyqtarë. Edhe pse kjo gjykatë ka numër më të vogël volum pune, gjithsesi, në kushtet kur ligji parashikon që nuk mund të jetë gjykata me më pak se 7 (shtatë) gjyqtarë, nuk mund të kemi një numër të ndryshëm.

Për sa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mbetet i njëjti propozim, 23 (njëzet e tre) gjyqtarë, sikundër ka konkluduar edhe eksperti në analizën e të dhënave statistikore deri në 2020, edhe të dhënat e tjera për vitin 2021 dhe 2022 nuk tregojnë rritje ose nevojë për të rritur numrin e gjyqtarëve.

Për sa i përket Elbasanit, propozimi im është jo 20 (njëzet) gjyqtarë, por 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë, për arsye se 7629 çështje të reja mesatare për 4 vite, 2019-2022, pjesëtuar me 429, lejojnë gjykimin e tyre nga një numër prej 18 gjyqtarësh.

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, propozimi mbetet i njëjtë 21 (njëzet e një) gjyqtarë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, propozimi im është për 7 (shtatë) gjyqtarë dhe jo për 8 (tetë) gjyqtarë, pasi 2673 çështje që është ngarkesa mesatare vjetore e gjykatës referuar çështjeve të reja, pjesëtuar me 429, kërkojnë në fakt një numër prej 6.2 gjyqtarësh, por duke qenë se nuk mund të ketë gjykata me më pak se 7 (shtatë) gjyqtarë, mbetemi në numrin e përcaktuar në ligj për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Gjirokastrë me 7 (shtatë) gjyqtarë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, propozimi ka ardhur për 16 (gjashtëmbëdhjetë), ndërkohë që referuar të dhënave statistikore të reja të administruara 6262 kërkojnë një numër prej 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarësh.

Për Gjykatën e Kukësit nuk ka ndryshim, për 7 (shtatë) gjyqtarë.

Për Gjykatën e Lezhës, të dhënat e reja statistikore e justifikojnë një numër prej 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarësh (janë 4717 çështje, pjesëtuar 429, del konkretisht 10.99), pra duhet 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Për Gjykatën e Tiranës nevojat janë për 87 (tetëdhjetë e shtatë), por në kushtet kur ne nuk mund të dalim tej numrit 235 dhe nuk mund të dalim tej bashkimit matematikor, propozimi im është për 80 gjyqtarë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për

6534 çështje mesatare për katër vite të reja, pjesëtuar me 429, kërkesa është për 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë dhe jo për 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nuk ka ndryshim në numër.

Ndërkohë që për për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë 6701 çështje mesatare ngarkese të çështjeve të reja për katër vite, pjesëtuar me 429, kërkojnë nevojën për 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Ky ndryshim i propozimit nuk tejkalon numrin 235 të gjyqtarëve për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Brikena!

Marçela Shehu: Kryetare, më fal!

Kisha edhe unë diçka.

Naureda Llagami: Po!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Në fakt unë nuk kundërshtoj as argumentin dhe as të dhënat që paraqiti sot zonja Ukperaj, por duke qenë se propozimi i ardhur si nga Komisioni ashtu edhe nga grupi i punës për implementimin e hartës së re gjyqësore bazohet në një raport të caktuar vlerësimi, punuar nga një ekspert, unë do të isha kundër që ne t'i bënim këto ndryshime sot në mbledhje plenare, për shkak se nëse të dhënat na paraqiten ndryshe dhe situata na paraqitet ndryshe, atëherë do duhej një rivlerësim tërësor i situatës, sërish nga i njëjti ekspert apo nga një ekspert tjetër, i cili do të rikonsideronte jo vetëm të dhënat statistikore, por të gjithë ato elementë që ai ka konsideruar dhe vlerësuar në momentin që ka hartuar raportin e tij të vlerësimit dhe bazuar në të cilin edhe grupi i punës dhe komisioni përkatës ka paraqitur edhe propozimin sot.

Gjithsesi, ky është mendimi im. Unë do vlerësoja që nëse ka nevojë për një rivlerësim, ky rivlerësim të bëhet nga eksperti. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Brikena Ukperaj: Mundem zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, Këshilli ka të gjithë kapacitetet e mundshme dhe administron të gjitha të dhënat statistikore nga gjykata. Raporti i ekspertit që na ka ndihmuar në përgatitjen e vendimit për hartën gjyqësore, raportit të hartës gjyqësore, sigurisht bazohet në të dhënat statistikore të grumbulluara deri në vitin 2020 dhe ky raport e ka nxjerrë, pra ne nuk ndryshojmë normën prej 429 çështjesh të reja për gjyqtar, bazuar në të njëjtin komponent 38.1% komplekse dhe 61.9% të lehta, për të rillogaritur numrin e gjyqtarëve. Pra numrin e gjyqtarëve nuk kemi asnjë pengesë dhe nuk mendoj që është i nevojshëm një raport eksperti shtesë për ta nxjerrë me të dhëna statistikore që ne i administrojmë dhe i kemi nëpër tabela. Përveç kësaj, përcaktimi i numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është një çështje urgjence që duhet të bëhet nga Këshilli sepse nga ky numër janë të ndërvarura një sërë aktesh të tjera që duhet të miratohen brenda muajit prill, për ta bërë të mundur fillimin e funksionimit në datën 1 maj të të gjitha gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Propozimi im në disa gjykata nuk ka një lëvizje drastike të numrit të gjyqtarëve. Ajo që ka shumë nevojë sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është evidente që duhet të jetë një rritje e numrit të gjyqtarëve edhe për ngarkesën që ka gjykata. Për këtë arsye propozova që të ruajmë bashkimin matematikor 80 dhe për të gjitha gjykatat e tjera në fakt të jemi në kuadër të analizës matematikore të të dhënave (nuk është se kemi dalë nga analiza matematikore). Kemi pjesëtuar 429 që eksperti e ka përcaktuar dhe që ne e kemi marrë në analizë kur kemi përcaktuar mënyrën e bashkimit të gjykatave, por me ngarkesën mesatare për gjyqtar për katër vite të gjykatave. Pra është e dhënë më e freskuar dhe më e apdejtuar. Kështu që, në vlerësimin tim, nuk do të ishte e nevojshme që të bëhej pikërisht në këtë moment një akt vlerësimi tjetër nga ana e ekspertëve.

Sigurisht, nëse në kuadër të përcaktimit të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, do të kërkohet në vijim, sidomos për gjykatat e apelit administrativ apo Gjykatën e Lartë, apo edhe për gjykatat administrative, një raport më i detajuar me të dhënat e fundit. Por në kushtet kur jemi (të themi) në momentin që ne nuk mundemi dot të mos e përcaktojmë numrin e gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nuk kemi ndonjë pengesë për ta përcaktuar në këtë moment, pa qenë e nevojshme që të presim një ekspertim të ri apo një mendim tjetër nga ana e ekspertit. Faleminderit!

Marçela Shehu: A mund të shtoj edhe unë diçka?

Naureda Llagami: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Atëherë, unë e nisa fjalën time duke thënë që unë nuk kundërshtoj as argumentin, as statistikat që u paraqitën. Do vlerësoja argumentin e dytë të zonjës Ukperaj që nuk kemi luksin e kohës për të pritur rivlerësimet e tjera, sepse miratimi dhe përcaktimi i numrit të gjyqtarëve, afekton edhe miratimin e akteve të tjera nga Këshilli, që do të bënin të mundur implementimin e hartës së re gjyqësore, por nuk mund të pranoj dot argumentin që nuk ka nevojë për një ekspertizë në rastin konkret. Nëse do të ishte situata e tillë, atëherë nuk kishim pse ne të diskutonim dhe të merreshim me vlerësimin e ekspertit që në fillimet e tij.

Gjithashtu, dua të them që përveç numrit të çështjeve të reja, i cili është një nga kriteret në të cilin është bazuar eksperti, janë vlerësuar edhe kritere të tjera siç është lloji dhe vështirësia e çështjeve. Pra, eksperti ka punuar me një metodologji të caktuar, ka përdorur një logjikë të caktuar si ekspert i kësaj fushe dhe ka arritur në një konkluzion. Gjithsesi ky mbetet një vlerësim i Këshillit. Unë e përmenda që në fillim, unë si anëtare e grupit të punës për implementimin e hartës do të isha e mendimit që procesi t'i nënshtrohej rivlerësimit nëse Këshilli do duhet të lëvizë në numra. Faleminderit!

Ilir Rusi: Mundet të bëj një koment drejtuese e seancës?

Naureda Llagami: Po, zoti Rusi!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Natyrisht që të gjitha mendimet, pavarësisht se çfarë përcaktimesh apo epitetin kanë, qoftë ekspert apo anëtar Këshilli, janë të vlefshme. Vendimmarrja ka vlerën e vet kur merret në kohë dhe në momentin e duhur. Tashmë ne jemi në momentin më kulmor në lidhje me fazën e dytë për riorganizimin e hartës së re gjyqësore, që ka të bëjë me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në këtë moment, duke marrë në konsideratë të gjitha afatet kohore përkatëse për ta bërë funksionale gjykatën e riorganizuar në datën 1 maj, jo vetëm në raport me ushtrimin e misionit, që ka lidhje me numrin e gjyqtarëve, por edhe me nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë dhe punonjës të tjerë, ne na duhet një miratim sa më i shpejt dhe i tashëm në lidhje me numrin e gjyqtarëve për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

E dëgjova me vëmendjen parashtrësën e zonjës Ukperaj, natyrisht edhe të zonjës Shehu, nuk është se cedojmë nga referencat statistikore për të përcaktuar numrin e gjyqtarëve sipas gjykatave. Ajo që prezantoi zonja Ukperaj ka të bëjë me aktualitetin, duke pasur parasysh që dinamika është shumë e madhe dhe lëvizin statistikatat, dhe akti i ekspertimit është bërë në një moment më të mëparshëm, ndërsa referimi që bën zonja Ukperaj është në raport me aktualitetin dhe kjo është një vendimmarrje që ne i shkojmë sa më afër realitetit ku marrim në konsideratë të dhënat aktuale. Ajo është matematikë dhe matematika ka edhe ato përafrimet e veta në numra. Unë e kam theksuar edhe gjatë punës në grupin e hartës, që e thënë ndryshe me një metaforë, ne jemi sekretariati i KLGJ-së për faktin sepse ato projekt-aktet tona i kalojnë mbledhjes plenare për miratim, natyrisht kur të gjithë anëtarët kanë ato opinionet e tyre dhe qëndrimet e tyre sipas rastit. Meqenëse koha e ndodhjes së tyre, janë në kohë të ndryshme nga njëra-tjetra, si eksperti kur ka bërë aktin, si ne kur kemi hartuar projekt-aktet, si sot që po bëhet mbledhja plenare, por që po e them edhe një herë, jemi në pikën kritike (për mirë gjithmonë) për ta finalizuar këtë proces (grupin e akteve) në lidhje me fazën e dytë, me qëllim që ne t'i japim kohë edhe Komisionit të Ristrukturimit për të funksionuar (që ka të bëjë me punonjësit civilë gjyqësorë). Njëkohësisht, edhe vetë gjyqtari me një status të veçantë por edhe me statusin e punëmarrësit duhet ta ketë të qartë këtë, që në datën 1 maj në cilën

gjykatë do të jetë pjesë e saj, nëse ai preket nga këto numra në gjykata, por në ato gjykata që do të preket matematika apo dekreti aktual që është në fuqi në lidhje me numrin e tyre sipas gjykatave përkatëse të cilat bashkohen.

Kështu që, në përfundim të këtij momenti do të thosha (nëse s'ka diskutime të tjera) që meqenëse edhe ne kemi bërë projektaktet në kohë të caktuar, eksperti ka bërë një punë në një kohë të caktuar, vlerësimi i zonjës Ukperaj është në këtë moment, unë do të mbështesja propozimin e bërë nga zonja Ukperaj në lidhje me një rishpërndarje të numrit të gjyqtarëve sipas gjykatave, qoftë atyre që riorganizohen, pra që bashkohen, qoftë edhe ato që nuk bashkohen. Njëkohësisht, është me vlerë, që duhet theksuar, që ne për disa gjykata kemi ruajtur numrin minimal që përcakton ligji (në lidhje me numrin 7) për ekzistencën e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, nëse nga anëtarët nuk ka më diskutime. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e zonjës Ukperaj!

Irena Plaku: Pro me propozimin.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. Gjithashtu përgëzoj grupin e punës për punën që kanë bërë dhe fleksibilitetin që tregoi në përputhje me gjendjen aktuale.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Kundër, bazuar në argumentin që parashtrova.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është si më poshtë:

1. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, 8 (tetë) gjyqtarë.

2. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, 7 (shtatë) gjyqtarë.

3. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, 23 (njëzet e tre) gjyqtarë.

4. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë.

5. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, 21 (njëzet e një) gjyqtarë.

6. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, 7 (shtatë) gjyqtarë.

7. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

8. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, 7 (shtatë) gjyqtarë.

9. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë.

10. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, 7 (shtatë) gjyqtarë.

11. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

12. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 80 (tetëdhjetë) gjyqtarë.

13. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
4. **Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
5. **Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
6. **Valbona Bala, Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL), Sarmela Titka, (INL, Ambasada Amerikane)**
7. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e dytë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, i përgatitur ky në fakt nga grupi i punës, dhe do të relatohet nga Drejtori i Departamentit z. Kelment Greca. Të lutem shkurtimisht lidhur me projekt–aktin, si produkt i grupit të punës.

Kelment Greca: Shkurtimisht po bashkëlidh disa nga gjetjet e relacionit.

Është pika 5 e nenit 64 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Këshilli i

Lartë Gjyqësor me vendim përcakton tre kategoritë e kancelarëve, në përputhje me ngarkesën dhe nivelin e çdo gjykate”. Nisur nga ky fakt lind nevoja e kategorizimit të gjykatave.

Në përcaktimin e kategorive të gjykatave, duke iu referuar hartës së re gjyqësore, është marrë në analizë, sikurse përcaktohet nga neni 64 gërshetimi i disa komponentëve të cilat janë: (i) niveli i gjykatës; (ii) mesatarja e çështjeve të reja të regjistruara për periudhën 2019-2022; (iii) numri i gjyqtarëve sipas drafteve dhe miratimit të KLGJ-së (që sapo kaloi).

Fillimisht është marrë në konsideratë niveli i gjykatës, sipas ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Bazuar mbi këtë kriter janë klasifikuar si gjykata të kategorisë së parë ose kategori e lartë, Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Apelit Administrativ.

Më specifikisht, Gjykata e Lartë është kategorizuar si gjykatë e kategorisë së parë, për hir të llojit të gjykimit që ajo realizon, por njëkohësisht duke mbajtur në konsideratë nivelin e ngarkesës së gjykatës, referuar jo vetëm regjistrimeve të reja, por edhe numrit të lartë të çështjeve të mbartura, të cilat, në raste si Gjykata e Lartë, përbëjnë ngarkesën reale të punës për gjyqtarët dhe stafin mbështetës në gjykatë.

Për analogji, janë klasifikuar si gjykata të kategorisë së parë apo të lartë, 3 gjykatat e apelit në vend. Ndonëse Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk plotëson kriterin për numër çështjet të regjistruara, janë vlerësuar të një kategorie të lartë për shkak të karakteristikave të gjykimit që kryhet në këto gjykata.

Në këtë kategori është klasifikuar gjithashtu Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilën është përlllogaritur mesatarja e numrit të çështjeve të regjistruara në gjykatat e apelit, sipas hartës së vjetër gjyqësore. Rezulton se kjo gjykatë plotëson njëkohësisht kushtin e ngarkesës dhe atë të nivelit të gjykatës.

Bazuar mbi kriterin e dytë, mesatarja e çështjeve të regjistruara të reja për periudhën 2019–2022, janë përfshirë gjithashtu në kategorinë e parë gjykatat e shkallës së parë me ngarkesë më të lartë. Të tilla rezultojnë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Gjithashtu, është përfshirë në kategorinë më të lartë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin, e cila pavarësisht se raporton një numër të ulët të çështjeve të regjistruara, 2,027 çështje të reja në vit, është kategorizuar si e nivelit të lartë për shkak të nivelit të pagës të gjyqtarëve (kategoria G2), si dhe natyrës së çështjeve që gjykon si gjykatë me vështirësi pune të lartë, sikurse përcaktohet edhe në ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.

Sa i përket kriterit të dytë të kategorizimit të gjykatave, ngarkesës së tyre, është përlllogaritur mesatarja e numrit të çështjeve të regjistruara gjatë afatit kohor 2019–2022. Nga analiza statistikore rezulton se mesatarja e çështjeve të regjistruara në rang vendi varion nga 245 çështje deri në 37.000 çështje të reja të regjistruara mesatarisht në vit. Duke marrë në konsideratë këtë variacion është realizuar ndarja në 3 segmente. Kategoria e tretë, pra kategoria e ulët përfshinë gjykatat deri në 3.000 çështje, kategoria e dytë ose mesatare ngarkesën nga 3 001 çështje – 11 000 çështje dhe kategoria e parë gjykatat me mbi 11.000 çështje të reja të regjistruara mesatarisht.

Kriteri i tretë, numri i gjyqtarëve, është vlerësuar duke marrë në konsideratë projektvendimet për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata. Në kategorinë e tretë është vlerësuar të përfshihen ato gjykata, që janë parashikuar me një numër të ulët gjyqtarësh, në nga 7 gjyqtarë. Kategoria e dytë numrin e gjyqtarëve e kanë nga 8–23 gjyqtar dhe si kategori e parë është mbi 24 gjyqtarë.

Është përlllogaritur edhe një efekt financiar dhe përlllogaritja është bashkëngjitur.

Në përfundim të analizës propozohet ndarja e kategorive ku përfshihen 4 gjykata në kategorinë e tretë, 9 gjykata në kategorinë e dytë dhe 7 gjykata në kategorinë e parë, si vijon:

Në kategorinë e parë janë:

1. Gjykata e Lartë;
2. Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm;
3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
4. Gjykata e Apelit Administrativ;
5. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

6. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;

Në kategorinë e dytë janë 9 gjykata si: Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë, Berat, Lezhë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë.

Gjykatat e kategorisë së tretë përfshihen gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Dibër, Gjirokastrë, Sarandë (dhe Kukës.)

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas propozimit të bërë nga grupi i punës?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Përcaktimin e kategorive të gjykatave si më poshtë:

I. Kategoria e parë (e lartë):

a. Gjykata e Lartë;

b. Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm;

c. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

d. Gjykata e Apelit Administrativ;

e. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

f. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

g. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;

II. Kategoria e dytë (e mesme):

a. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

b. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

c. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

d. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

e. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

f. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;

g. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;

h. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

i. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë;

III. Kategoria tretë (e ulët):

a. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

b. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;

c. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

d. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të punonjësve të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë me zyra shërbimi”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Rezarta Taushani, Maela Aicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Valbona Bala, Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL), Sarmela Titka, (INL, Ambasada Amerikane)

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të punonjësve të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë me zyra shërbimi”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të punonjësve të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë”. Për më shumë detaje, ftoj zotin Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit Kryetare!

Projekt-aktet kanë të bëjnë me tre kategori përkatëse. Një kategori ka të bëjë me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë me zyra shërbimi. Akti i dytë ka të bëjë me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë me zyra shërbimi. Akti tjetër ka të bëjë me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë pa zyra shërbimi.

Në lidhje me relacionin përkatës do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që disa paragrafë janë të përsëritur për shkak edhe të mbledhjeve të shpeshta që janë bërë në lidhje me hartën... dhe do mendoja të kaloja tek pjesa e relacionit që ka të bëjë konkretisht me objektin e këtij projektvendimi.

Në lidhje me “shpjegim i detajuar i përmbajtjes së aktit”:

Rregullat e përgjithshme standarde për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë me zyra shërbimi gjenden të ndara në 5 (pesë) krerë, të cilët në mënyrë të përmbledhur përmbajnë rregullime si vijon:

Kreu I i projektvendimit, titulluar “Dispozita të përgjithshme”, përfshin 3 nene të cilat përcaktojnë objektin, qëllimin dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Konkretisht, qëllimi i projektvendimit është plotësimi i bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e strukturës së brendshme të gjykatës, për të bërë të mundur funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të veprimtarisë së kësaj gjykate. Parimet e organizimit dhe funksionimit të kësaj gjykate janë: hierarkia e sistemit gjyqësor, llogaridhënia, ligjshmëria, efektiviteti, paanshmëria, transparencja, aksesimi në drejtësi, si dhe bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke respektuar, në të njëjtën kohë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve të saj.

Kreu II i projektvendimit, titulluar “Struktura organizative dhe organet vendimmarrëse të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”, përfshin 2 nene, të cilat rendisin respektivisht të gjitha njësitë përbërëse të gjykatës dhe organet vendimmarrëse, pavarësisht rolit që ato kanë, ose funksionit që kryejnë, detajime këto të cilat rregullohen në dispozitat në vijim. Neni 4 rendit si vijon:

- a) Kryetari;
- b) Trupa gjyqësore;
- c) Kancelari;
- ç) Kryesekretari;
- d) Sekretaria Gjyqësore;
- dh) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
- e) Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;
- ë) Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë;
- f) Sektori i Protokollit dhe Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit.

Ndërsa më tej, në nenin 5 janë parashikuar vetëm organet vendimmarrëse të gjykatës, duke përcaktuar funksionin e tyre kryesor. Organet vendimmarrëse për mbarëvajtjen gjyqësore dhe administrative të Gjykatës së Lartë janë: a) Kryetari; b) Këshilli i Gjykatës; c) Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve; ç) Kancelari. Duke qenë se kompetencat e këtyre organeve janë të parashikuara në ligj thuajse në mënyrë shteruese, është vlerësuar që ato të mos pasqyrohen në projektvendim, me qëllim shmangien e përsëritjes së dispozitave ligjore, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha subjektet.

Dispozitat në vijim janë të organizuara në përputhje me parashikimet e nenit 41 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, i cili përcakton 3 shtyllat e shërbimeve në gjykata: shërbime gjyqësore, shërbime administrative dhe shërbime mbështetëse. Secili prej këtyre shërbimeve është rregulluar në një kre të veçantë.

Kreu III i projektvendimit, titulluar “Shërbimet gjyqësore të gjykatës”, përbëhet nga 4 nene, të cilat detajojnë strukturat që kryejnë shërbime gjyqësore. Këtu përfshihen: a) Kryesekretari; b) Sekretari gjyqësor. Edhe këto struktura janë të parashikuara në ligj

me kompetenca konkrete, prandaj projektvendim liston funksionet kryesore, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat në përshkrimin e punës sipas Aneksit 2.

Kreu IV i projektvendimit, titulluar “Shërbimet administrative dhe mbështetëse dhe funksionet e tyre”, përmban 5 nene të cilat detajojnë strukturat që kryejnë vetëm shërbime administrative dhe mbështetëse sipas ligjit.

Neni 10 liston strukturat që ofrojnë shërbimet administrative, si vijon:

- a) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
- b) Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;
- c) Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, e Median;
- ç) Sektori i Protokollit dhe Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit.

Ky nen bën dallimin midis strukturave administrative dhe atyre mbështetëse, duke evidentuar qartë edhe statusin e nëpunësve që ushtrojnë respektivisht funksione administrative apo mbështetëse, organet e emërtesës apo të shkarkimit të tyre. Strukturat e shërbimeve administrative janë përgjegjëse për mirëfunksionimin e veprimtarive administrative të gjykatës, kurse shërbimet mbështetëse sigurojnë ruajtjen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës, si dhe garantimin e ushtrimit të funksioneve gjyqësore dhe administrative.

Për efekt të organizimit më efektiv të veprimtarisë së brendshme të gjykatës, strukturat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë ideuar si kombinime midis shërbimeve administrative dhe atyre mbështetëse. Ndërsa shërbimet administrative realizohen nga nëpunës civilë gjyqësorë. Vendimi qartëson se sipas rastit shërbimet mbështetëse mund të ushtrohen nga nëpunës civilë gjyqësorë, që kryejnë detyrat sipas përshkrimeve të punës bashkëlidhur kësaj rregullore dhe atyre të miratuara nga Këshilli i Gjykatës, por edhe nga punonjës të tjerë gjyqësorë që emërohen dhe shkarkohen nga Kancelari dhe marrëdhëniet e punës së tyre rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 11 parashikon Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Vendimi propozon organizimin e kësaj strukture në formën e drejtorisë, kërkesë e cila buron edhe nga legjislacioni i posaçëm financiar, por edhe nga madhësia e gjykatave të kategorisë së

parë. Ndërkohë detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civilë gjyqësorë – specialist buxheti dhe specialist finance gjenden të detajuara në përshkrimet e punës.

Neni 12 parashikon Sektorin e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, strukturë e cila kombinon 3 shërbime: 2 (dy) të natyrës administrative (burimet njerëzore dhe prokurimet) dhe 1 (një) të natyrës mbështetëse. Edhe në këtë rast dispozita plotësohet me përshkrimet e punës së specialistëve të këtij sektori.

Neni 13 parashikon Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, strukturë e cila kombinon 2 (dy) shërbime të natyrës administrative, ato që lidhen me Teknologjinë e Informacionit e Statistikat dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë.

Neni 14 parashikon Sektorin e Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit. Përveç shërbimeve të Protokollit dhe Arkivës, risia e këtij neni është parashikimi i detyrave të zyrës së shërbimeve që ngrihet dhe funksionon për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor. Duke qenë se këto rregullat standarde objekt shqyrtimi gjejnë zbatim për kategorinë e gjykatave të mëdha të juridiksionit të përgjithshëm, dhe si e tillë në këtë fazë krijohet vetëm Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nenet 13 dhe 14 gjejnë zbatim për zyrën e shërbimeve Krujë.

Zyra e Shërbimit është pjesë e strukturës organizative të gjykatës pritëse. Kjo zyrë do të ushtrojë veprimtarinë me numrin e nevojshëm të punonjësve për dhënien e shërbimit dhe për ruajtjen e arkivave të gjykatave që bashkohen. Në këtë mënyrë nuk do të jetë e nevojshme lëvizja e arkivit të gjykatës si dhe krijohet mundësia e punësimit të një pjese të stafit administrativ të gjykatës që do të bashkohet me një tjetër. Këto zyra krijojnë më shumë fleksibilitet dhe lehtësi në aksesin në gjykatë të përdoruesve të gjykatave, po edhe për gjykatën kryesore në marrjen e kërkesave apo dokumenteve si dhe bashkimin e tyre me pjesën tjetër të kërkesave që do të shqyrtohen nga gjykata. Po ashtu, krijimi i zyrave nuk kërkon ndërhyrje të mëtejshme në ligjet procedurale përkatëse.

Çdo zyrë shërbimi përbëhet nga të paktën 2 (dy) nëpunës civilë gjyqësorë që ushtrojnë funksionet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje. Nëpunësit civilë gjyqësorë që ushtrojnë funksionet pranë zyrave të shërbimeve në rrethe, marrin në dorëzim dhe përcjellin pa vonesë për trajtim në strukturën qendrore të shërbimeve

gjqësore ose administrative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, çdo kërkesë ose dokument që paraqitet nga palët në një proces gjyqësor, përfaqësuesit ligjorë, përdoruesit e tjerë të gjykatës si dhe çdo subjekt tjetër i interesuar. Kancelari mbikëqyr funksionimin e zyrës së shërbimeve dhe siguron koordinimin me shërbimet e tjera të gjykatës.

Funksionet e zyrës së shërbimit plotësohen edhe nga neni 14, e cila është një dispozitë kalimtare që synon të normojë tërësinë e veprimeve që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 30 prill 2023, duke i ngarkuar punonjësve të ZSH-ve kryerjen e të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor, të tilla si:

- a. komunikimin e vendimeve gjyqësore palëve ndërgjyqëse;
- b. pranimin, regjistrimin e ankimeve civile, penale dhe të masave të sigurimit në regjistrin e ankimeve, në sistemin e menaxhimit të çështjeve, si dhe në indekset e ankimeve;
- c. komunikimin e ankimit, kundërankimit (nëse ka) dhe pas përfundimit të veprimeve bën përcjelljen e dosjeve civile, penale për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- ç. kontrollon kryerjen e rregullt ose jo të komunikimit të vendimeve dhe kalon dosjet për formë të prerë;
- d. bën pritjen e përdoruesve të gjykatës, lidhur me ankimet e çështjeve gjyqësore dhe informon lidhur me ecurinë e dosjes;
- dh. pas përfundimit të afatit të ankimimit nëse nuk ka ankim, dorëzon dosjet pranë zyrës së arkivës së gjykatës;
- e. kryerjen e detyrave të tjera sipas nevojës dhe delegimit nga Kryesekretari apo Kancelari i Gjykatës.

Së fundi, Kreu V përcakton organet dhe tërësinë e veprimeve duhet të përmbushen për zbatimin e këtij vendimi nga data 1 maj 2023 e në vijim.

Konkretisht, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Këshilli i Gjykatës pritëse miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës. Miratimi i sa më sipër lidhet ngushtë me ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, që është

objekt rregullimi me një akt të veçantë, i cili detajon tërësinë e rregullave dhe procedurave që duhet të zhvillohen e përfundohen deri në datën 30 prill 2023. Këto procedura lidhen ekskluzivisht me transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe jo me plotësimin e pozicioneve të reja të nivelit drejtor apo shef sektori. Verifikimi i pozicioneve vakante do të bëhet nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, por vijimi i procedurave të rekrutimit për pozicionet vakante mund të vijojë vetëm pas përfundimit të procesit të riorganizimit të kompetencave territoriale të gjykatave.

Aneksi 1 pasqyron organigramën standarde të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Parë me zyra shërbimi, bashkë me detajimin e pozicioneve në strukturë.

Aneksi 2 përmban përshkrimet standarde të punës, detyrave dhe përgjegjësive për secilën pozicion të punonjësve të gjykatave. Në çdo përshkrim gjenden sipas një strukture të mirëorganizuar: emërtesa e pozicionit dhe njësia organizative; qëllimi i pozicionit; detyra kryesore; përgjegjësitë kryesore në drejtim të planifikimit, menaxhimit, detyrave teknike apo bashkëpunimit dhe përfaqësimit institucional; zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; mjedisit menaxherial; mbikëqyrjes; stafit në varësi; kushteve të punës e kriterëve të veçanta të arsimit, përvojës profesionale e kriterëve të tjera ligjore. Vlen të theksohet se për çdo pozicion nëpunësi civil gjyqësor janë përshkruar veprimtaritë që ata kryejnë rregullisht, sipas kërkesave të ligjit.

Në lidhje me zbatimin e këtij akti ngarkohet Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprimet e nevojshme deri në datën 30 prill 2023 dhe, nga data 1 maj 2023, Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për sa më sipër në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet, miratimi i “Rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të punonjësve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Parë me zyra shërbimi”, sipas tekstit dhe Anekseve 1 dhe 2 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky ishte relatimi për sa i përket aktit përcaktuar në pikën 3 të rendit të ditës.

Naureda Llagami: Zoti Rusi nuk dëgjoresh.

Ilir Rusi: Nuk e di Kryetare nëse u dëgjova në relativitet, sepse unë sapo e përfundova?

Naureda Llagami: Zoti Rusi, këtë të fundit jo, nuk e dëgjuam.

Ilir Rusi: Ky ishte relativiteti im për sa i përket projektvendimit të parashikuar në pikën 3 të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe të punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë me zyrë shërbimi. Është shtuar togfjalëshi “ me zyrë shërbimi”, “me zyrë shërbimi” në njëjës, sepse ka zyrë shërbimi vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor (aktualisht) Krujë e cila do të bashkohet me Gjykatën e Tiranës dhe do të ofrojë shërbime në këtë gjykatë, duke marrë në konsideratë edhe vendimin që sapo miratua “Mbi kategorizimin e gjykatave”, dhe si gjykatë e kategorisë së parë është Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Naureda Llagami: Faleminderit, me gjithë propozimin që keni bërë.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit, nëse nuk ka diskutime nga kolegët?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Parë, me Zyrë Shërbimi”, sipas tekstit dhe Anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, pa zyra shërbimi”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Rezarta Taushani, Maela Alicantaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Valbona Bala, Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL), Sarmela Titka, (INL, Ambasada Amerikane)

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, pa zyra shërbimi”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili do të relatohet po nga zoti Rusi, që ka të bëjë me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, pa zyra shërbimi. Zoti Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit Kryetare!

Në lidhje me projekt-aktin përkatës që ju përmendët, pa zyra shërbimi; kemi dy kategori aktesh: një me zyra shërbimi dhe një pa zyra shërbimi.

Meqenëse në të tre këto kategori të gjitha shërbimet që ofrohen janë pothuajse të njëjta, ndryshimi mes tyre ka të bëjë me faktin nëse ka apo nuk ka zyra shërbimi dhe kjo ka të bëjë në lidhje me përcaktimet nëse bashkohet gjykata me një gjykatë tjetër apo jo, sepse kemi disa gjykata që nuk bashkohen me gjykata të tjera (gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë, Elbasan, Sarandë dhe Berat). Këto janë gjykata të kategorisë së dytë dhe të tretë, sipas aktit që sapo miratua në këtë mbledhje të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Meqenëse këto gjykata nuk bashkohen me gjykata të tjera, atëherë në këto gjykata nuk do të ketë zyra shërbimi, prandaj edhe në emërimin e tyre është “kategoria e dytë dhe e tretë pa zyra shërbimi”.

Përmbajtja e relacionit është pothuajse e njëjtë. Është ky ndryshim, që nuk ka zyra shërbimi, dhe një ndryshim tjetër është që për shkak edhe të kategorizimit, nuk kemi një drejtori të menaxhimit të buxhetit dhe financiar, por kemi sektor të menaxhimit të buxhetit dhe financiar dhe kemi dhe referencat përkatëse.

Gjithashtu, duhet theksuar fakti dhe duhet hequr nga relacioni dhe nga projektvendimi përkatës, është që në këto gjykata të kategorisë së dytë dhe të tretë të cilat nuk bashkohen me gjykata të tjera, nuk kemi emërtesën “Këshill i Gjykatës pritëse”. Ky do ishte ndryshimi përkatës i cili reflektohet nga ana ime dhe relatohet edhe për miratim nga anëtarët.

Pra që edhe ne të jemi efektiv me kohën, përmbajtja e relacionit është pothuajse e njëjtë. Kemi ndryshim në lidhje, së pari, nuk ka zyrë shërbimi; së dyti, meqenëse është kategoria e dytë dhe e tretë, nuk ka Drejtori të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar por kemi Sektor të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; dhe ky akt ka të bëjë me katër gjykata të cilat për shkak të VKM-së nuk bashkohen me gjykata të tjera, që janë gjykata e Elbasanit, Vlorës, Beratit dhe Sarandës, dhe nuk kemi emërtimin “Këshill gjykate pritëse”.

Ky ishte relatimi në lidhje me këtë projekt-akt e nderuar Kryetare.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Propozimi përkatës është për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, pa zyra shërbimi. Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë, pa Zyra Shërbimi”, sipas tekstit dhe Anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Valbona Bala, Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL), Sarmela Titka, (INL, Ambasada Amerikane)

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në..

Ilir Rusi: Tek projekt-akti “...kategoria e dytë dhe të tretë, me zyra shërbimi”.

Faleminderit kryetare!

Natyra e këtyre akteve është pothuajse e njëjtë, thjesht diferenca ka të bëjë me kategorizimin e gjykatave, kategoria e dytë dhe e tretë dhe meqenëse kemi kategorinë e dytë dhe të tretë, në ndryshim nga kategoria e parë nuk do kemi Drejtori të Menaxhimit të Buxhetit dhe Financiar por do të kemi Sektor të Menaxhimit të Buxhetit dhe Financiar.

Në ndryshim nga akti tjetër që miratuar, kategoria e dytë dhe e tretë pa zyra shërbimi, kjo do të jetë kategoria e dytë dhe e tretë me zyra shërbimi, dhe janë përcaktuar sikundër edhe u relatua tek akti i gjykatave të kategorisë së parë, janë përcaktuar edhe zyrat e shërbimit në ato gjykata të cilat më datën 1 maj bashkohen me gjykatat e tjera mëmë dhe këtu kemi atë konceptin “gjykatë mëmë” dhe “gjykatë bijë” dhe rrjedhimisht do të kemi edhe ekzistencën e emërtesës “Këshilli i Gjykatës pritëse”.

Në koherencë edhe të aktit që kemi miratuar tashmë, kjo ka të bëjë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat e cila do të ketë zyrë shërbimi, e cila bashkohet me Dibrën. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila do ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykatën e Durrësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë do ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata e Përmetit do ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Gjykata e Kurbinit do ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Gjykata e Pukës do ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjykata e Pogradecit do ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjykata e Tropojës do të ketë zyrë shërbimi dhe bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Pa kaluar në përsëritje Kryetare, unë evidentova vetëm diferencën ndërmjet këtyre tre akteve sepse 90% e tyre janë të përafërta, thjesht ka ndryshim në ekzistencën apo jo të zyrës së shërbimit; ekzistenca apo jo e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Sektor të Menaxhimit Financiar; dhe ekzistenca e Këshillit të Gjykatës pritëse apo Këshilli i Gjykatës normal, jo pritës. Në aktin që sapo parashtrova, ka të bëjë me kategorinë e dytë dhe të tretë të gjykatave me zyra shërbimi dhe me diferencë nga akti në lidhje me gjykatat e kategorisë së dytë dhe të tretë pa zyra shërbimi, këtu do ketë zyra shërbimi, Sektor të Menaxhimit Financiar dhe këtu kemi edhe ekzistencën e gjykatës pritëse.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë diskutime apo jo. Ndryshe, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë, me Zyra Shërbimi”, sipas tekstit dhe Anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
- 4. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Valbona Bala, Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL), Sarmela Titka, (INL, Ambasada Amerikane)**
- 6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër, jo më pak i rëndësishëm, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, përgatitur edhe ky nga grupi i punës. Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish zotit Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit Kryetare!

Në vijim po parashtroj relacionin mbi projektvendimin “Për rishpërndarjen e

numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efikasitetit, administrimit efektiv të gjykatave, dhe sigurimit të mirëfunksionimit të tyre në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, ka filluar procesin për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Akti i paraqitur për miratim synon të përmbushë detyrimet kushtetuese e konkretisht: nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; parashikimet e nenit 90, shkronja “g” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, sipas të cilit Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata; parashikime të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; parashikime të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për rregullimin e marrëdhënieve për punonjës të tjerë të gjykatave, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.

Për sa i përket natyrës së aktit, akti i paraqitur për miratim synon të përmbushë objektivin strategjik për menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të cilat ushtrojnë veprimtari në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Ky objektiv merr rëndësi të veçantë në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, pasi gjykatat e riorganizuar do të kenë kapacitetet e nevojshme profesionale për të vijuar ofrimin e shërbimeve në kohën e duhur dhe me cilësi.

Pra, rishpërndarja dhe miratimi i numrit të pozicioneve të punës në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, lidhet ngushtë me administrimin efektiv të burimeve njerëzore. Detajimi i pozicioneve konkrete do të bëhet nga vetë gjykatat në bazë të nevojave por duke pasur parasysh numrin total të pozicioneve të punës të trajtuara me dispozita të shërbimit civil apo të Kodit të Punës.

Rishpërndarja është një produkt i dakordësuar në mbledhje nga anëtarët e Grupit

Ndërinstitucional të Punës. Në këtë relacion shpjegues parashtrohen dhe argumentohen zgjidhjet e propozuara për zbatimin efektiv të Hartës së Re Gjyqësore.

Për sa i përket komenteve, akti i propozuar për miratim ka për qëllim plotësimin e parashikimeve ligjore që autorizojnë KLGJ për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës, për pozicionimin e nëpunësve civilë gjyqësor apo punonjësve të tjerë administrative, duke zbatuar për aq sa është e mundur edhe rregullime konkrete të ligjit “Për Nëpunësin Civil”, si dhe praktikatat më të mira në këtë drejtim, me qëllim vijimin e funksionimit dhe përmbushjen e objektivave në datën 1 maj 2023.

Akti ka për qëllim miratimin e rishpërndarjes së numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në respektim dhe zbatim të vendimeve nr. 129, 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, të datës 28.03.2023 për fillimin e funksionimit të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të KLGJ-së, të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat përcaktojnë numrin e pozicioneve për funksionimin e strukturave (drejtori/sectorë) në institucione, si dhe mbështetur në numrin faktik të punonjësve/nëpunësve pranë gjykatave aktuale.

Grupi Ndërinstitucional i Punës, duke mbajtur në konsideratë, qëllimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemim të punonjësve, duke ruajtur numrin total të sistemit gjyqësor 1595 në total (408 gjyqtar dhe 1187 administratë gjyqësore dhe punonjës të tjerë), duke vlerësuar opinionet e dhëna nga kancelarët e gjykatave aktuale, në mbledhjen e zhvilluar të KLGJ-së, por edhe në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil publik, për aq sa lejohet dhe mundësohet, ka mundësuar sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur aktit, rishpërndarjen e pozicioneve të punës si dhe detajim të numrit të pozicioneve/punonjësve të gjykatave aktuale.

Sa më poshtë, paraqiten në formë tabelare, situata aktuale e pozicioneve të punës në gjykatat aktuale, si dhe rishpërndarja e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatat e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke respektuar kriterin ligjor për transferimin e përhershëm të nëpunësve/punonjësve të gjykatave, largësia nga vendi i punës jo më larg se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit, si dhe duke përlllogaritur vendet vakante në gjykatat e rretheve gjyqësore, të cilat do të riorganizohen në zbatim të implementimit të hartës gjyqësore.

Gjithashtu, bashkëlidhur projektvendimit është edhe tabela përkatëse, duke bërë edhe aktualitetin se sa është numri i punonjësve dhe si do të bëhet rishpërndarja e numrave nëpërmjet nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë.

Akti i propozuar do të zbatohet nga Këshillat aktualë të Gjykatave, nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime nga kolegët, kalojmë në votimin e propozimit të ardhur nga grupi i punës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të miratojë rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Gjykatat e rretheve gjyqësore pritëse të bëjnë detajimin e pozicioneve të punës, në mbështetje të numrit të rishpërndarjes dhe nevojave.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).⁷

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}”, projekt-akt i cili është propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit Kryetare!

Parashtroj relacionin mbi projektvendimin “Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}”.

Për kandidatin {...}, pasi ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës është vijuar procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore dhe me vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë”, të ndryshuar, bëri emërimin e tij gjyqtar, mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit

nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu Këshilli, duke mbajtur parasysh pozicionet e lira në sistemin gjyqësor, me vendimin nr. 112, datë 13.03.2022, shpalli 4 (katër) pozicione të lira për të diplomuarin {...} në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht neni 39, i Ligjit 96/2016, thekson që gjyqtarët e diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, pas emërimit të tyre si gjyqtar, kanë përparësi në caktimin e tyre në pozicion, parashikon që ky caktim bëhet duke respektuar kriteret si vijon:

a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, të bërë nga Shkolla e Magjistraturës, bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale;

b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar, për tre gjykata.

Për sa i përket renditjes, z. {...} ishte renditur i 4-ti në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar, në vitin akademik 2021–2022 të bërë nga Shkolla e Magjistraturës bazuar në rezultatet e tyre të studimeve. Por në kushtet kur për z. {...} Këshilli me vendimin nr.273, datë 20.07.2022 vendosi: “Pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për t’u emëruar magjistrat z. {...}, të filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 21, datë 17.01.2022, deri në përfundimin me vendim të formës së prerë të procedurës së hetimit disiplinor të filluar nga Prokurori për Disiplinën pranë Shkollës së Magjistraturës”, procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës së këtij kandidati zgjati në kohë.

Pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i drejtoreshin vetëm këtij magjistrati. Në përfundim të afatit të caktuar me vendimin nr. 112, datë 13.03.2023, magjistrati z. Keraj, me deklaratën e tij datë 17.03.2023 paraqiti 3 (tre) preferencat e tij si më poshtë:

Preferencë e parë – Pukë; Preferencë e dytë – Sarandë; Preferencë e tretë – Përmet.

Sa më sipër, bazuar në kriteret ligjore, pra në pikën 3, të nenit 39, të Ligjit 96/2016, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 86, të

Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës ka hartuar projektvendimin për caktimin në pozicion të gjyqtarit {...}.

Në këtë propozim Komisioni ka mbajtur në konsideratë preferencën e tij të parë.

Vlen të theksohet se, sipas germës “a”, pika 1, të nenit 41 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që përcakton të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”, parashikohet se “I emëruari duhet të pranojë pozicionin e ofruar në përputhje me nenet 39 dhe 40, të këtij ligji, duke përfshirë: a) pozicionin që nuk është deklaruar në preferencat e tij; ...”.

Propozimi sipas pikës 1 të projektvendimit konsiston në caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar si më poshtë: Zotit {...} pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Pukë, preferencë e parë e deklaruar nga gjyqtari në deklaratën e protokolluar me aktin nr. 1902, datë 17.03.2023.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit, kjo në përputhje me përcaktimin e pikës 3, të nenit 37, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “3. ... Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Këshillit konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të ushtrimit të funksionit të magjistratit.”.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe gjykatës përkatëse të rrethit gjyqësor ku ai caktohet.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo në përputhje me përcaktimet e bëra: - në pikën 2, të nenit 41, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Së fundmi parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj!
Atëherë, nëse nuk kemi diskutime mbi projekt-aktin, unë propozoj ta hedhim në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).⁸

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani, Maela Alicantaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të raportohet nga zonja Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

Me vendimin nr. 44, datë 27.01.2023, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në

Këshillin e Lartë Gjyqësor, për 1 (një) pozicion “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve.

Në zbatim të vendimit të mësipërm, kanë shfaqur vullnetin për komandim 2 (dy) gjyqtare, një prej të cilave në datën 08.03.2023, ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin përkatës. Nga ana e Këshillit në mbledhje plenare të datës 13.03.2023, pasi është miratuar opinioni në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për komandim dhe cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës, është vendosur:

Vijimi i procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidaten gjyqtare: {...}.

Në këtë kuadër, referuar vendimit të Këshillit nr.44, datë 27.01.2023, Komisioni filloi fazën e dytë të procedurës së komandimit, me qëllim kryerjen e vlerësimit të gjyqtarës {...}, për të cilën ishte lejuar më herët nga Këshilli fillimi i procedurave.

Në fazën e dytë, procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kritereve të komandimit. Vlerësimi u bë nga Komisioni në rastin konkret mbi baza dokumentare, bazuar në të dhënat e dosjes personale dhe dokumentacionit të depozituar rishtazi në Këshill bashkëlidhur kërkesës për komandim pa u vlerësuar i nevojshëm intervistimi.

Gjatë procedurës së vlerësimit, Komisioni pati parasysh edhe kriteret preferenciale të parashikuara në Vendimin nr. 44, datë 27.01.2023, sipas të cilit, ka përparësi kandidati që plotëson këto kritere:

- a) ka ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatore;
- b) ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemin gjyqësor;
- c) është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës;
- d) ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- e) ka aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Gjyqtarja {...} ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016, duke i përfunduar ato në vitin 2019 dhe për sa i përket aftësive profesionale gjatë studimeve trevjeçare, është vlerësuar “Shumë mirë”, duke u renditur e para ndër

magjistratët e diplomuar për këtë viti akademik. Me vendimin nr.1, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj.{...} është emëruar gjyqtare dhe më pas me vendimin nr.42, datë 29.01.2020 është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrijë detyrën, me një përvojë profesionale prej 3 vjetësh, periudhë gjatë të cilës gjyqtarja ka shqyrtuar çështje të të gjitha fushave të së drejtës, si civile, penale dhe familjare.

Nga pesë dokumentet ligjore të paraqitur prej saj, konkludohet se ajo ka aftësi shumë të mira profesionale. Në çdo dokument ligjor, gjyqtarja i referohet pretendimeve dhe të dhënave që janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, përmend dhe analizon bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe analizohen provat në drejtim të saj. Të pesë dokumentet ligjore janë të mirëstrukturuar, të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët e vendimit kanë lidhje dhe janë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Nuk gjen në pjesën arsyetuese kundërthënie argumentesh, apo mospërputhje me pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin logjik.

Lidhur me aftësitë organizative referuar të dhënave statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për vitin 2022, të administruar nga Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor konstatohet se gjyqtarja përgjatë viti 2022 ka përfunduar gjykimin për 989 çështje, nga 1069 çështje që ka pasur për shqyrtim. Ky indikator është tregues për gjyqtaren për aftësi të mira organizative. I njëjti konstatim evidentohet edhe nga mënyra e arsyetimit të 5 (pesë) dokumenteve ligjore, pavarësisht se nga ana e Komisionit nuk është bërë vlerësim i dosjeve konkrete.

Gjyqtarja përgjatë viteve 2020-2022 rezulton të jetë angazhuar në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses në disa trajnime, çka tregon se ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale.

Lidhur me kriterin preferencial të kandidimit – autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës – nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtarja, rezulton se gjyqtarja është bashkautore në studimin “Përmbledhje të praktikës gjyqësore për Drejtësinë Penale për të Miturit”, botuar në janar të vitit 2020.

Gjithashtu, autore e artikullit “Vështimet e një kandidati për gjyqtar lidhur me të drejtat e bashkëshortit në veprimtarinë tregtare, referuar praktikës gjyqësore shqiptare”, botuar në artikullin shkencor “Të drejtat e grave mbi shoqëritë tregtare që janë pjesë e bashkëjetesës ligjore”, i Universitet të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Lidhur me kriterin preferencial të kandidimit – njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian – nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtarja, rezulton se ajo ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, si dhe njohuri të mira të gjuhës italiane dhe asaj franceze.

Lidhur me kriterin preferencial të kandidimit – njohuri mbi legjislationin të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi aktet ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor – nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, nuk rezultojnë të dhëna mbi njohuri të legjislationit të vendeve të Bashkimit Evropian, apo akte ndërkombëtare në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor, por nga ana tjetër rezulton se gjyqtarja është angazhuar në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses në trajnimin me temë “Të drejtat e personalitetit dhe liria e shprehjes së gjyqtarëve (jurisprudenca kushtetuese dhe jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me të drejtat e personalitetit dhe lirinë e shprehjes së gjyqtarëve”.

Referuar të dhënave të mësipërme, Komisioni ka vlerësuar se kjo gjyqtare shfaq aftësi shumë të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe ka eksperiencë personale në draftimin e akteve rregullatore. Për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, apo edhe të veprimtarive të tjera jashtë këtij funksioni, ajo shfaq aftësi interpretuese dhe zbatuese të ligjit, si dhe aftësi teknike për kërkime ligjore mbi legjisllacione të vendeve të Bashkimit Evropian, akte ndërkombëtare apo jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër, referuar kriterëve preferencialë të parashikuar në pikën 4 të vendimit nr. 44, datë 27.01.2023 në rastin konkret nuk mund të bëhet një renditje e gjyqtarëve, pasi numri i pozicioneve të shpallura të lirë për komandim është i njëjtë me numrin e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet e kriteret e komandimit.

Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon mbledhjes plenare:

1. Komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Afati i komandimit është 2 vjet. Duke marrë në konsideratë nevojshmërinë që ka struktura dhe ritmin e shqyrtimit gjyqësor sipas K.Pr.Civile, ku ndryshimi i trupit gjykues si rregull nuk përbën shkak për fillimin e gjykimit nga e para, komandimi propozohet të fillojë në datën 11.04.2023.

Komisioni propozon gjithashtu, që deri në fillimin e periudhës së komandimit, gjyqtarja duhet të përjashtohet nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Rupa!

Propozimi për datën?

Yllka Rupa: Propozimi për datën ishte 11.04.2023.

Naureda Llagami: Hedhim në votim nëse nuk kemi diskutime nga kolegët.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon nga data 11.04.2023.

3. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, për shkak të një angazhimi në cilësinë e Kryetares, unë po largohem nga mbledhja për t’ia lënë zotit Rusi drejtimin e mbledhjes për dy çështjet e tjera. Faleminderit!

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).⁹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 3. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami** e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 9.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

2. **Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

3. **Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

5. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Në vijim të rendit të ditës, po vazhdojmë me pikën 9 të saj, shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatores zonjës Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju parashtoj në mënyrë të përmbledhur relacionin për projektvendimin ‘Për

mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për gjyqtaren {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, si dhe Vendimit nr. 263 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka si detyrë të fillojë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, është protokolluar në datën 16.02.2023 vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, së bashku me dosjen, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar e drejta e ankimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit, ka rezultuar se znj. {...} në periudhën tetor 2013 – korrik 2016 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë periudhës nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është dekretuar me dekretin e Presidentit të Republikës me nr.{...}, datë 20.11.2015. Me vendimin nr.13, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtarja është caktuar në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, gjyqtarja {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarës vetëm në periudhën e kryerjes së praktikës profesionale në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, nga muaji nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016, për një kohëzgjatje prej 8 muajsh e 11 ditë. Ndërsa është caktuar për të ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 10.02.2017 (jashtë periudhës së rivlerësimit kalimtar).

Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin i kohës nr.8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe rregulloren e brendshme është parashikuar se Shkolla e Magjistraturës përbëhet nga tre vite. Viti i tretë përkon me kryerjen e praktikës së stazhit aktiv, në përfundim të të cilit këshilli pedagogjik bën vlerësimin e kandidatëve dhe më pas renditjen e tyre.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të kohës, referuar më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së

Magjistraturës, ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshtruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtarja {...} e ka pasur statusin e gjyqtarës edhe gjatë praktikës profesionale, që korrespondon me vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtën periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të 3-të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të 3-të ka pasur statusin e gjyqtarit.

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “... Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur.” Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij vendimi. Për të përcaktuar më pas vlerësimi bëhet nga ana e Këshillit.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit “Për Statusin”, vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur. Me termin “Ligj” nuk kuptohet vetëm Ligji për Statusin, por edhe ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence të organit, siç është në rastin konkret ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”, që ka qenë në fuqi në momentin konkret. Në rastin konkret, duke qenë se për periudhën nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016, gjyqtarja ka kryer stazhin profesional, që përkon me vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës ka bërë vlerësimin e saj, mbi bazën e së cilës më pas është bërë renditja dhe emërimi i saj nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit, rezulton se ajo nuk është

caktuar dhe nuk ka ushtruar detyrën si gjyqtare gjatë periudhës së vlerësimit, pasi ajo është caktuar si gjyqtare vetëm në datë 10.02.2017.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor, konkretisht neni 84 të ligjit “Për statusin” dhe vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, në kushtet kur rezultoi se gjyqtarja nuk ka ushtruar detyrën si gjyqtare, pas përfundimit të stazhin profesional, gjatë periudhës së vlerësimit 2013–2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimit në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të ligjit “Për statusin”, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3-vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të fillojë.

Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative, në lidhje me nenin 171 të ligjit “Për statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit me vendim të formës së prerë;

2) Periudha e stazhit profesional të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;

3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr.86, datë 07.12.2022, vendim i cili ka rrëzuar padinë e gjyqtarit për të cilin është vendosur përfundimi i procedurës së vlerësimit për shkak se nuk ekzistonte periudha njëvjeçare e vlerësimit, e konfirmon edhe këtë qëndrim të Këshillit.

Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve ligjore për fillimin e procedurës së vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 171/5 për gjyqtaren {...}, Këshilli duhet të vendosë mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për periudhën e vlerësimit 2013–2016. Ndërkohë që për periudhën e vlerësimit 2017–2019 për të njëjtin gjyqtare Këshilli ka filluar vlerësimin e saj etik dhe profesional.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtaren {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, pasi nuk plotësohen kushtet për

fillimin e kësaj procedure, në kushtet kur gjyqtarja nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarit gjatë kësaj periudhë vlerësimi, pas përfundimit të stazhit profesional.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për mosfillimin e procedurës së vlerësimit duhet t'i njoftohet gjyqtares {...}.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë.

Në projektvendim përcaktohet edhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë pas botimit në faqen zyrtare të internetit.

Njoftoj paraprakisht se gjyqtarja është njoftuar për seancën e sotme dhe për projektvendimin për mosfillimin e procedurës dhe ajo ka shprehur dakordësi me qëndrimin se konsideron që nuk përmbushen kriteret ligjore por ka vënë në dukje në fakt që Këshilli ka mbajtur një qëndrim të mëparshëm kur ka kryer një vlerësim etik dhe profesional që i është dërguar KPK-së, vendimmarrje që është kontradiktore në këtë raport, por gjithsesi ka shprehur dakordësinë e saj.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët e Këshillit prezent në mbledhje nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet Znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017–2019, relatores znj. Brikena Ukperaj.¹⁰

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 3. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

¹⁰ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami** e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 9.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017–2019, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Ilir Rusi: Për më tej, vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës, shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017–2019, relatore znj. Brikena Ukperaj. Për më tej fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Gjyqtarja {...} ka qenë pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2021. Është vlerësuar për periudhën trevjeçare 2017–2019. Këtij projektraporti i bashkëngjitet edhe raporti analitik në të cilin janë të shpjeguar në mënyrë të hollësishme të gjitha të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit.

Gjyqtarja është njoftuar për projektraportin e vlerësimit, për raportin analitik, për të drejtën e saj për t'u njohur me materialin e dosjes së vlerësimit, për të paraqitur kundërshtime, prova të tjera, dhe nëpërmjet e-mailit dhe komunikimit të saj elektronik ka shprehur dakordësinë e saj me konkluzionet e projektraportit të vlerësimit. Nuk ka

paraqitur kundërshtime, prova të tjera dhe as ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore në Këshill.

Në këto kushte unë do të ndalem vetëm në konkluzionet e arritura nga ana ime si relatore për secilin nga treguesit e katër kritereve të vlerësimit.

Në pjesën e parë të projektraportit pasqyrohet e gjithë procedura e ndjekur deri në momentin e njoftimit të vendimit gjyqtarës {...}.

Për sa i përket kriterit të parë që ka të bëjë me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, treguesi “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është konkluduar se:

Në tërësi, gjyqtarja shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, i) si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ii) ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitikë, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Evidentohet aftësi shumë e lartë e gjyqtarës në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Për këtë arsye propozimi për këtë tregues është shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 25 pikë.

Për sa i përket treguesit të dytë “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, nga tërësia e burimeve të vlerësimit është konkluduar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo atyre material. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdes i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si

dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Prandaj është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 25 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 15 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, është konkluduar se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Për këtë arsye propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, në tërësi rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë edhe lidhur me këtë tregues. Cilësia e analizës dhe argumentimit ndjek rregullin: fakt- normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Për këtë arsye është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 25 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” propozohet nivel shumë i lartë i vlerësimit shkëlqyeshëm, pikët 100.

Për sa i përket kriterit të dytë “Aftësia organizative e gjyqtarës”, treguesi “Respektimi i afateve ligjore”. Pasi është bërë një analizë matematikore dhe logjike e

të gjitha të dhënave statistikore, ka rezultuar se nga 420 çështje në periudhën trevjeçare, për të cilat ka qenë e parashikuar në ligj një afat për përfundimin e tyre, rezulton që gjyqtarja ka përfunduar jashtë afatit ligjor 48 çështje ose rreth 11.4% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 12 pikë. Nga ana tjetër, në metodologji lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, duke marrë për bazë ngarkesën e lartë të gjyqtares, referuar faktit se për periudhën 6-mujore qershor 2018 – janar 2019 ajo në fakt ka përballuar një ngarkesë pune në dy gjykata, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë sepse edhe pse ka qenë e transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, sipas vendimit të Këshillit në atë kohë, i është lënë që duhet të përfundonte të gjitha çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Duke marrë në konsideratë mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve; numrin e lartë të çështjeve me afat ligjor, 420 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 30% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në periudhën e vlerësimit; gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe tejkalimin e pragut të përqindjes që çon në pikëzim maksimal vetëm me 1,4%, në cilësinë e relatores propozoj që gjyqtarja për këtë tregues të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi nga ai që rezulton nga analiza matematikore, dhe konkretisht me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, në tërësi, duke bërë analizë matematikore dhe logjike të të dhënave statistikore, rezulton se 965 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 202 prej tyre ose rreth 20% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor, i cili sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

Edhe për pikëzimin e këtij treguesi, në zbatim të metodologjisë, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares si dhe duke marrë në konsideratë raportin e çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat

zbatohet ky afat, në masën 20%; mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve; treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2017–2019, ku rezulton se gjyqtarja në total ka përfunduar 1385 çështje, nga të cilat 672 çështje me palë kundërshtare; natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore ku hapësira e vlerësueses është më e madhe se ajo e afateve ligjore; ngarkesën e lartë të gjyqtarës, si dhe faktin që përsëri edhe këtu që ajo për një periudhë 6–muajore ka mbuluar punën në dy gjykata; kam vlerësuar se pavarësisht përqindjes së mësipërme, sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë, për këtë tregues, gjyqtarja duhet të vlerësohet me një nivel me të lartë pikëzimi, konkretisht me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 9 nga 11 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për dy nga kategoritë e çështjeve “Familjare pa palë kundërshtare” dhe “Tregtare pa palë kundërshtare”, duke u tejkaluar ky afat respektivisht me 33 ditë për kategorinë e parë dhe 72 ditë për kategorinë e dytë. Bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e “Plotësimit të standardeve minimale kohore” si dhe duke vlerësuar kategoritë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkaluar, ku ndjeshëm kanë ndikuar kërkesat “Për çelje procedure falimenti”, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja, bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore, duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore, pra jo me 4 por me 5 pikë

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, për vitin 2017 gjyqtarja përfunduar 147 çështje me palë kundërshtare, më pak se standardin sasior; – për vitin 2018 ka përfunduar 248 çështje me palë kundërshtare, duke kaluar standardin sasior me 48 çështje ose 24%; – për vitin 2019 ka përfunduar 277 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar standardin sasior me 77 çështje ose 38.5%; Ndërkohë që për të gjithë periudhën, rendimenti si raport i çështjeve të përfunduara me çështjet e caktuara, të

përfunduara janë 1385 çështje, të caktuara janë 1524 çështje, është 90.8%, që sipas metodologjisë pikëzohet me 6 pikë.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti që sipas metodologjisë na rezulton në masën 90.8%, por duke referuar tejkalimin e standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 12%, si dhe ka duke marrë për bazë numrin e çështjeve pa palë kundërshtare të shqyrtuara nga ana e gjyqtarës (713 çështje), në cilësinë e relatores kam propozuar që ajo të pikëzohet me një nivel më të lartë, pra me 8 pikë, por jo në nivelin maksimal me 10 pikë, sepse nuk ka kaluar standardin sasior që metodologjia kërkon i cili kërkon që duhet të jetë më shumë se 50% për çështjet me palë kundërshtare.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit gjyqësor”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, pasi vetëm për tre nënkategori rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me 0.8 ditë çka e bën atë të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë dhe për një prej nënkategoritë, afati procedural i arsytimit është tejkaluar me 6,5 ditë, ndërkohë që për të gjitha kategoritë e tjera afati i arsytimit rezulton më i shkurtër dhe në një pjesë të tyre i barabartë me afatin procedural. Por ky tejkalim afati vetëm për një nënkategori çështjesh, si dhe kohëzgjatja e këtij tejkalimit, sipas metodologjisë në rastin konkret kam vlerësuar se justifikojnë zbatimin e një niveli më të lartë pikëzimi bazuar në koeficientin 20%, me pasojë pikëzimin me 15 pikë të gjyqtarës për këtë tregues.

Për sa i përket treguesit tjetër të numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, bazuar në këtë tregues, nga vëzhgimi i dosjeve me palë kundërshtare, duke qenë se nuk kemi të dhëna statistikore për të gjithë numrin e seancave gjyqësore të realizuara, rezulton se numri mesatar i seancave është 3 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Për këtë arsye, për këtë tregues, është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, referuar raportit analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë

vendim për caktimin e seancës përgatitore ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Çështjet e përzgjedhura me short gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, e them këtë përgjithësisht. Sepse rezulton që për çështjet me objekt “dërgimi për gjyq”, në zbatim të nenit 332 të K.Pr.Penale, pika 2, nga data e depozitimit të kërkesës deri në datën e seancës së parë gjyqësore, koha nuk duhet të kalonte më shumë se 10 ditë (është detyrim i ligjit); ndërkohë evidentohet se në të gjitha çështjet pothuajse të përzgjedhura me short “dërgim për gjyq”, seancat gjyqësore rezultojnë të jenë caktuar jashtë këtij afati ligjor, konkretisht mbas 14, 20, 14, dhe 20 ditësh. Ka qenë e vetmja kjo problematikë e evidentuar nga këqyrja dhe vëzhgimi i dosjeve të përzgjedhura për vlerësim; ndërkohë që në të gjitha rastet e tjera gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, relativimin e akteve të njoftimit, shkaqet e mosparaqitjes, ecurinë e gjykimit, dhe duke argumentuar dhe duke analizuar edhe vendimet e saj të ndërmjetme lidhur me kërkesat e palëve apo për nevoja të procesit gjyqësor.

Në kushtet kur është konstatuar një mosrespektim i përsëritur, në katër dosje, i afatit ligjor për kryerjen e një veprimi konkret procedural siç ishte data e caktimit të seancës së parë gjyqësore (evidentoj këtu për çështjet e dërgimit në gjyq), pavarësisht se këto çështje ishin përfunduar brenda ose jashtë afatit 30-ditor, në projektraport vlerësimi kam vlerësuar që gjyqtarja duhet të vlerësohet me aftësinë mbi mesatare, duke u pikëzuar me 16 pikë.

Gjyqtarja nuk e ka kundërshtuar vetë këtë vlerësim nga ana e relatorit. Pavarësisht kësaj, duke marrë parasysh qëndrimin e fundit që mbajti Këshilli në vlerësimin e gjyqtarës së fundit, znj. {...}, e cila kishte të njëjtën problematikë, por kjo problematikë, me sa kam kuptuar, buron nga vetë ligji sepse në K.Pr.Penale ka dy dispozita: neni 332 dhe neni 332/a të cilët siç duket i vë gjyqtarët në vështirësi për respektimin e afatit 10-ditor sepse, neni 332 parashikon se nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq deri në datën e seancës, nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë. Pra nëse gjyqtarët do të detyrohen të zbatojnë këtë dispozitë (sikundër jemi në rastin e gjyqtarës {...}), atëherë seanca e parë nuk duhet të caktohet më tepër se 10 ditë nga data e regjistrimit të çështjes. Por përveç kësaj, ka edhe një dispozitë tjetër që është neni

332/a që bën fjalë për veprimet përgatitore, dhe thotë: “Gjyqtari i seancës paraprake njofton të pandehurin dhe viktimën ose trashëgimtarët, etj., etj. 2. Data e seancës i njoftohet gjithashtu prokurorit dhe mbrojtësit... 3. Njoftimet sipas paragrafëve 1 dhe 2 duhet të bëhen të paktën dhjetë ditë para seancës”.

Pra duke pasur dy dispozita që në fakt duket që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën lidhur me afati se kur duhet të lihet seanca e parë gjyqësore, vlerësoj se pavarësisht se gjyqtarja për këtë tregues nuk ka paraqitur kundërshtime, sikundër edhe gjyqtarët e tjerë që mund të vlerësohen për të njëjtën periudhë vlerësimi për mosrespektim të nenit 332, të mos pikëzohet me 16 pikë, por të pikëzohet me 20 pikë sepse dukshëm kjo gjë buron nga parashikimi në ligj i dy dispozitave në mënyrë të ndryshme lidhur me datën se kur do të jetë seanca dhe datën që do lihet palëve për t’i njoftuar për seancën e parë gjyqësore. Prandaj në cilësinë e relatores, duke e konstatuar këtë problem të ligjit, vlerësoj që lidhur me këtë tregues, pavarësisht se gjyqtarja nuk ka bërë kundërshtime, por është një çështje që realisht buron nga dispozitat ligjore, të mos pikëzohet me 16 pikë, por të pikëzohet me 20 pikë.

Lidhur me “Aftësinë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, “Rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes” është vlerësuar maksimalisht, pasi dosja renditet në rend kronologjik në mënyrë të tillë që të bëhet lehtësisht e aksesueshme. Ato paraqiten në aspektin formal në rregull, janë të numërtuara dhe nga ana tjetër nuk konstatohet mungesë dokumentacioni apo prania e akteve dhe dokumentave që nuk i përkasin çështjeve të analizuara.

Në përfundim, për kriterin e dytë të “Aftësive organizative”, propozimi im nuk është 94 pikë, por pas propozimit për rritjen e pikëve në treguesin paraardhës, propozoj që për këtë kriter gjyqtarja të pikëzohet në total me 98 pikë, niveli Shkëlqyeshëm.

Për sa i përket kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, duke qenë se të gjithë treguesit e këtij kriteri pothuajse bazohen në të njëjtat burime, do t’i përmbledh për të gjithë të dhënat që kanë rezultuar nga burimet e vlerësimit. Janë administruar nga ILD-ja të gjitha të dhënat e verifikimit të ankesave për gjyqtaren në periudhën 2017–2019. Ka pasur 8 ankesa të cilat janë verifikuar. Për të tetë ankesat është vendosur arkivimi i tyre pas shqyrtimit fillestar. Nuk ka të referuar nga ILD-ja asnjë

ankesë për t'u marrë parasysh në vlerësimin etik dhe profesional sepse kryesisht ato kanë qenë pretendime që lidhen nëpërmjet rrugës së ankimit gjyqësor. Nuk ka pasur masa disiplinore të dhëna apo të zbatuara gjatë kësaj periudhe, pavarësisht shuarjes së tyre. Nuk ka pasur të dhëna të tjera që mund të konsiderohen referuar mendimit të relatorit. Në këto kushte, edhe për treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, për treguesin “Integriteti”, propozohet pikëzimi maksimal, bazuar edhe në parimin e prezumimit i cili sipas metodologjisë lejon vlerësuesin që të marrë në analizë të dhënat vetëm në rastin kur ato do të afektonin pikëzimin maksimal, që është 100 pikë.

Për sa i përket “Paanësisë së gjyqtarës”, “Përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese”, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pasi nga analiza e burimeve të vlerësimit, nuk ka rezultuar në asnjë rast përdorimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i një gjuhe të tillë në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve, apo në aktet shkresore të hartuara nga ana e gjyqtarës.

Për sa i përket treguesit të fundit të këtij kriteri, ka rezultuar që për periudhën trevjeçare ka pasur vetëm 4 kërkesa të pranuar por gjithsesi ato nuk kanë qenë për shkak të konfliktit të interesit, ndërkohë që ka 12 kërkesa për heqje dorë, që janë gjithashtu të pranuar të gjitha nga ana e kryetarit. Në këto kushte, për këtë tregues, numri i kërkesave të pranuar vlerësohet i pakonsiderueshëm. Pikëzimi 15 pikë.

Niveli i vlerësimit për kriterin e tretë propozohet “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” – “Aftësitë e komunikimit” dhe “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, për “Shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta”, për “Shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore”, bazuar në të dhënat e burimeve të vlerësimit, kryesisht këtu mendimin e kryetarit, nuk ka rezultuar të dhëna që mund të afektonin secilin nga këta tregues. Për këtë arsye është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, duke u pikëzuar me pikët maksimale për secilin nga këta tregues, sipas metodologjisë.

Për sa i përket “Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit 2017–2019, gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht në tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 23 aktivitete të

zhvilluara për 45 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare dhe pikëzimi është me 20 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, ka rezultuar që gjyqtarja gjatë kësaj kohe ka qenë e angazhuar pranë Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuese në 3 (tre) aktivitete trajnuese. Për këtë arsye, duke qenë se ka pasur të dhëna është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruar në raport analitik, në cilësinë e relatores kam vlerësuar që nuk ka të dhëna që mund të konsiderohen në kuadër të këtij treguesi. Në fakt gjyqtarja ka parashtruar se gjatë vitit 2015 ka qenë anëtare e Unionit të Gjyqtarëve Shqiptarë, po ashtu prej marsit të vitit 2018 ka qenë anëtare e Bordit Drejtues të Unionit të Gjyqtarëve, me të vetmin qëllim mbrojtën e të drejtave të gjyqtarëve dhe përmirësimin e sistemit gjyqësor. Prej themelimit nëntor 2018 dhe në vijim ka qenë anëtare e Bordit të Forumit të Grave Gjyqtare Shqiptare dhe prej muajit janar 2020 është Kryetare e këtij Forumi. Në cilësinë e anëtares së Bordit të Forumit të Gjyqtarëve ka dhënë kontribut (shpjegon gjyqtarja) për promovimin e lidershit të grave gjyqtare dhe përmirësimin e sistemit gjyqësor. Në kuadër të këtyre organizimeve gjyqtarja ka parashtruar se ka marrë pjesë në Trajnimin Menaxhimi Jo-fitimprurës organizuar në 2019 nga USAID në bashkëpunim me Forumin e Grave Gjyqtare Shqiptare për fuqizimin e Forumit. Gjithashtu ka qenë pjesëmarrëse në Konferencën e Organizuar për Lançimi i publikimit "Dhuna ndaj grave në familje”.

Në cilësinë e relatores kam vlerësuar se në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstitucionale, kjo e fundit duhet të provohet nëpërmjet një kontributi dhe angazhimi efektiv të gjyqtarit. Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyrë të ndryshme, përfshirë veprimtari jashtë funksionit me ose pa pagesë, të tilla si fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; etj. Në këtë kuadër, vetëm pjesëmarrja e gjyqtarës në bord apo aktivitete nuk

përbën veprimtari ndërinstitucionale. Duhet kontribut efektiv, qëndrim që kemi mbajtur edhe në vlerësimet e mëparshme.

Për këtë arsye kam vlerësuar që kontributi i dhënë nga ana e gjyqtares në këto raste, i pretenduar prej saj si veprimtari ndërinstitucionale, nuk përbën veprimtari ndërinstitucionale dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme që të rritet pikëzimi nga 3 në 5 pikë. Kam vlerësuar që pikëzimi për këtë tregues duhet të mbetet me 3 pikë.

Për sa i përket publikimeve ligjore akademike, nuk ka të dhëna për publikimet e gjyqtares dhe pikëzimi është me 0 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e katërt, publikimet ligjore akademike, propozimi për shkallën e aftësisë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe 93 pikë.

Përfundimisht, për secilin nga katër kriteret e vlerësimit:

Kriteri i parë “Aftësitë profesionale” – 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

Kriteri i dytë “Aftësitë organizative” – fillimisht ishte 94, propozoj që të bëhet 98 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” – 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” – 93 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, pikët 391.

Në fund janë përpiluar edhe rekomandimet konkrete për gjyqtaren, që kryesisht konsistojnë në mbajtjen në konsideratë të saj për t’u angazhuar në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua nga zonja Ukperaj.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor prezent në mbledhje, ftoj anëtarët për votimin e projektvendimit sipas propozimeve të bëra gjatë relatimit nga zonja Ukperaj.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën 2017–2019”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95, pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.03.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).¹¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami** e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 9.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani, Maela Alicantaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit.

Alban Toro: Faleminderit Kryetar!

Duke marrë shkas që është një material i përgatitur kohë më parë, do e paraqes në mënyrë të sintetizuar. Objekti i këtij relatimi është kërkesa që paraqitur dhe administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Gjykata e Lartë, e cila kërkon të plotësojë njësinë e

saj të shërbimit ligjor nëpërmjet figurave të ndihmësmagjistratëve, pra gjyqtarëve të komanduar pranë saj.

Më konkretisht, me shkresën e tyre përcaktohet se periudha për të cilën kërkohet të komandohen 4 ose 5 magjistratë në njësinë e shërbimit ligjor është 5 vjet. Gjithashtu nisur nga fakti se puna e ndihmësmagjistratit është e orientuar në funksion këshillues dhe ndihmës është me rëndësi që të ndiqen disa kritere bazë për përzgjedhjen e kandidatave si:

- Përvoja profesionale dhe specializimi në fushën civile, penale dhe administrative;

- Njohja e jurisprudencës vendase dhe ndërkombëtare;

- Rezultatet e studimeve dhe performanca gjatë formimit fillestar dhe vazhdues;

- Njohja e të paktën një gjuhe të huaj të vendeve të Bashkimit Evropian;

- Aftësi shumë të mira të komunikimit profesional dhe njerëzor.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit për Statusin, në pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë, për 5(pesë) pozicione të lira në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, propozim për të cilin është përgatitur projektvendimi “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Komisioni vlerëson se procedura të fillojë për hapjen e 5 (pesë) pozicioneve në raport me kërkesën prej 14 ndihmësmagjistratëve që kërkohen prej Gjykatës së Lartë; ky konkluzion vjen duke mbajtur në konsideratë organikën aktuale nga struktura organizative në gjykatat e shkallëve I në raport me efektet që do të sjellë implementimi i hartës së re gjyqësore; ii) masat e ndërmarra së fundmi nga Këshilli për lëvizjet paralele dhe transferimet e përkohshme.

Sipas këtij projektvendimi hapet procedura dhe shpallet kërkesa për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit të “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën e Lartë, sikundër përcaktohen afati, dokumentacioni, kohëzgjatja, kushtet dhe kriteret

preferenciale të kandidimit, sikurse jepet dhe informacioni për procedurën e komandimit, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit 54, të Ligjit për Statusin.

Në këtë kontekst është përgatitur drafti ku të gjithë këto elementë do t'i gjeni të përfshirë në dispozitivin e projektvendimit, ku në mënyrë të detajuar paraqitet hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura, si dhe kohëzgjatja, kriteret dhe procedurat e komandimit.

Në pikën tre të këtij projekti është vendosur edhe afati, gjithmonë nëse do kemi edhe sugjerime të tjera, mund të përfshihet edhe çdo sugjerim nga ana e kolegëve, pra si afat të paraqitjes së kërkesave për komandim kemi parashikuar deri në 15 ditë, pra aktualisht kemi vendosur datën 13.04.2023. Nëse nga kolegët do të ketë ndonjë sugjerim apo propozim shtesë... Me pak fjalë ky ishte relacioni dhe projekti që është paraqitur në përmbushje të detyrimit për t'i kthyer përgjigje shkresës së Gjykatës së Lartë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët e Këshillit prezent në mbledhje nëse kanë diskutime.

(Nuk kanë diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projekt-aktit.

Vetëm doja të saktësoja diçka zoti Toro. Afatin e paraqitjes së kërkesave për komandim, deri në çfarë date ta saktësoni.

Alban Toro: Ashtu siç edhe e citova, është data 13.04.2023, nëse nuk do të kishte ndonjë propozim nga ana e kolegëve për ta zgjeruar, pakësuar. Ajo që është në projekt është vendosur data 13.04 (15 ditë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit).

Ilir Rusi: Dakord, por meqenëse është kalendari me pushime i prillit... Dakord, nëse s'ka diskutime, dakord. 13.04. Është ditë e enjte.

Mirë atëherë, nëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit, në propozim të të cilit është edhe përcaktimi i datës në lidhje me paraqitjen e kërkesave për komandim.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit Gjykatën e Lartë.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë për 5 (pesë) pozicione “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim deri në datë 13.04.2023.

4. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë

b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail), ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, apo anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë;

dh) Vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;

e) Lista e rezultateve të studimeve dhe karakteristika e Shkollës së Magjistraturës nëse disponohet;

ë) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese si trajner, lehtësues, pjesëmarrës;

f) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;

g) Pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës ku të pasqyrohet njohja e jurisprudencës;

gj) Rekomandime si dhe çdo dokument tjetër për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;

h) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

5. Dokumentacioni sipas pikës 4, i këtij vendimi, dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

6. Kohëzgjatja e komandimit është 5 (pesë) vjet.

7. Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;

c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;

d) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;

e) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;

8. Kushtet e komandimit janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:

i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;

ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

dh) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

9. Kriteret preferenciale të komandimit:

a) Përvoja profesionale dhe specializimi në fushën administrative, civile ose penale;

b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;

c) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

ç) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;

d) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsyetimit ligjor;

dh) Aftësi shumë të mira të komunikimit profesional dhe njerëzor

10. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes së tij personale të administruar pranë Këshillit.

11. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

13. Gjykata e Lartë vlerëson aplikimet e kandidatëve dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

14. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata e Lartë.

15. Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit ose kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet nga Gjykata e Lartë, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rihapë procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Me shqyrtimin e kësaj pike, janë ezauruar dhe shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës për mbledhjen e sotme. Duke ju falënderuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Pasdite të qetë!

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor